



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6957 Prot.

Roskovec, më 26.11 2019

VENDIM

Nr. 102 datë 22/11 /2019

PËR

ANULIM TË VENDIMIT NR.93 DATË 23.10.2019
“NDËRTIM I RRETHRROTULLIMIT QENDËR ROSKOVEC” DHE
ANULIM TË VENDIMIT NR.96 DATË 23.10.2019 “NDËRTIM I 4 LULISHTE NË
FSHATIN VELMISH”

*Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr.44/2015
“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 113, shkresës Nr.1682/1
date 05.11.2019 të Prefektit të Qarkut Fier, Këshilli i Bashkisë,*

VENDOSI :

1. Anulimin e VKB Nr.93 datë 23.10.2019 “Ndërtim i rrethrotullimit Qendër Roskovec”.
2. Anulimin e VKB Nr.96 datë 23.10.2019 “Ndërtim i 4 lulishte në fshatin Velmish”
3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPERISË
PREFEKTI QARKU FIER

Nr 6138/prot
26.11.2019

Handwritten notes and signatures on the right side of the page, including the date 02.11.2019 and some illegible text.

Nr. 1682/1 Prot.

Fier, më 25.11.2019

Lën da: Kthim përgjigje për ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit Bashkiak Roskovec.

Drejtuar: Znj. Majlinda BUFI
KRYETARE E BASHKISË ROSKOVEC.

ROSKOVEC

Për dijëni: Z. Kadri HYSKA
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC.

ROSKOVEC

Në përgjigje të shkresës suaj me Nr. 6138 prot. datë 25.10.2019, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 1682 prot. Datë 29.10.2019, bazuar në Ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 16, shqyrtuam vendimet e Këshillit Bashkiak Roskovec të marra në mbledhjen e datës 23.10.2019 si dhe dokumentacionin plotësues për vendimet si më poshtë:

Vendimi Nr. 89 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec "Për mbarimin para kohe të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Roskovec" Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 49 pika 2, 4/b, 5.

Vendimi Nr. 90 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec "Mbi miratimin e fondit për pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe invalidëve të punës për periudhën 1-31 Tetor 2019" Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" datë 17.12.2015 neni 8 pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", Ligjin Nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" neni 31 si dhe në zbatim të VKM Nr. 618, datë 07.09.2006 "Për




përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar"(i ndryshuar).

Vendimi Nr. 91 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për periudhën 1-30 Shtator 2019” Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8 pika 2, 9, 24; Ligjin Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21; VKM-në Nr. 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfuturit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.5 datë 17.2.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%” (i ndryshuar).

Për Vendimin Nr. 92 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratimin e rregullores urbane për bllokun Nr. 2, Qendër Roskovec” do të shprehem kur të sillni aktin e konformitetit nga Agjensia e Zhvillimit të Territorrit pasi për bashkinë tuaj nuk ka ende një Plan të Përgjithshëm Vendor të miratuar, bazuar në Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorrit Nr.1 datë 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi ,deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore” (i ndryshuar) pika 5 dhe Udhëzimit Nr.1, datë 16.03.2017 “Për mënyrën dhe procedurat e zbatimit të planeve të përgjithshme vendore” i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 2 datë 14.04.2017 pika 17.

Vendimi Nr. 93 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Ndërtimi i rrethrotullimit Qendër Roskovec” Ju kthehet si i paligjshëm në bazë të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” neni 109 shkronja “a” për moskompetecë të Këshillit Bashkiak bazuar në Ligjin Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar) neni 12. Bazuar në Ligjin Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar) neni 29 shkronja “a” duke qenë se projekti përmban punime ndërtimi vendimmarrja në këtë rast është përgjegjësi e kryetarit të bashkisë. Bazuar në Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorrit Nr.1 datë 30.07.2017 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi ,deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore”, (i ndryshuar) pika 5, për këtë projekt ju duhet të vazhdoni procedurat me Agjencinë e Zhvillimit të Territorrit duke qenë se bashkia juaj nuk ka ende një Plan të Përgjithshëm Vendor të miratuar.

 **Vendimi Nr. 94 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratimin e fondit për “Projekt- Zbatimin dhe Preventivin përfundimtar për 8 Ujësjetllësa”** Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe në zbatim Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.

Vendimi Nr. 95 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratimin e ndryshimeve në strukturën e Bashkisë për vitin 2019” Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) neni 54 gërma “dh”, Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, Ligjin Nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019” dhe në zbatim Udhëzimin Nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.

Vendimi Nr. 96 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Ndërtimi i 4 Lulishte në Fshatin Velmish” Ju kthehet si i paligjshëm në bazë të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” neni 109 shkronja “a” për moskompetecë të Këshillit Bashkiak bazuar në Ligjin Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar) neni 12. Bazuar në Ligjin Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar) neni 29 shkronja “a” duke qenë se projekti përmban punime ndërtimi vendimmarrja në këtë rast është përgjegjësi e kryetarit të bashkisë. Bazuar në Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorrit Nr.1 date 30.07.2017 “Per percaktimin e rregullave dhe procedurave qe do te ndiqen nga autoritetet e zhvillimit te territorit per shqyrtimin e kerkesave per leje ndertimi ,deri ne miratimin e Planeve te Pergjithshme Vendore”, (i ndryshuar) pika 5, për këtë projekt ju duhet të vazhdoni procedurat me Agjencinë e Zhvillimit të Territorrit duke qenë se bashkia juaj nuk ka ende një Plan të Pergjithshëm Vendor të miratuar.

Vendimi Nr. 97 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Ndërtimi i Parkut Agroturistik dhe rehabilitimi i rrugës hyrëse të Fshatit Luar” do të shprehem kur të sillni aktin e konformitetit nga Agjencia e Zhvillimit të Territorrit pasi për bashkinë tuaj nuk ka ende një Plan të Pergjithshëm Vendor të miratuar, bazuar në Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorrit Nr.1 date 30.07.2015 “Per percaktimin e rregullave dhe procedurave qe do te ndiqen nga autoritetet e zhvillimit te territorit per shqyrtimin e kerkesave per leje ndertimi ,deri ne miratimin e Planeve te Pergjithshme Vendore” (i ndryshuar) pika 5 dhe Udhëzimit nr.1, date

SEKRETARIAT
I QARKUT

16.03.2017 “Për mënyrën dhe procedurat e zbatimit të planeve të përgjithshme vendore” i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 2 datë 14.04.2017 pika 17.

Vendimi Nr. 98 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratimin e fondit për projektin “Qendra e Kujdesit Ditor PAK” Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe në zbatim Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.

Vendimi Nr. 99 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për përbërjen e Këshillit Vendor për sigurinë publike” Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) neni 29 si dhe në zbatim Ligji Nr. 108/2014 “Për policinë e shtetit” neni 11 pika 3 gërma “d” dhe neni 78 pika 2.

Vendimi Nr. 100 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Miratimin e ndryshimit të destinacionit të përdorimit për subvencionin për vitin 2019 (603)” Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” dhe në zbatim Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”(i ndryshuar).

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,



PREFEKTI

Baki BALA

Handwritten signature and initials



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6143 Prot.

Roskovec, më 25, 10 2019

VENDIM

NR 93 .DATË 23 .10 .2019

“NDËRTIMI I RRETHRROTULLIMIT QENDËR ROSKOVEC”

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar , neni 23 pika 4 ; ligjin 107/2014, datë 31.07.2014 ”Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar neni 12 dhe 13, dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015,”Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”,i ndryshuar,Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e projektit të objektit “Ndërtimi i rrethrotullimit Qendër Roskovec”.
Projekti përmban punime ndërtimi dhe spostim i linjës elektrike.
Gjendja aktuale e rrugës vështirëson qarkullimin normal të banorëve dhe të mjeteve.
- 2- Vlera totale e projektit : 966 641 lekë me TVSH.
- 3- Nuk ka nevojë për financim pasi projekti do të mbulohet me materialet e blera gjatë vitit.
- 4- Punimet për realizimin e investimeve do të bëhen me punonjesit e Ndërmarrjes së Shërbimeve të Mirëmbajtjes së Rrugëve,e cila ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi.
- 5- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6146 Prot.

Roskovec, më 25.10 2019

VENDIM

NR. 96 .DATË 23.10 .2019

“NDËRTIMI I 4 LULISHTE NË FSHATIN VELMISH”

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 23 pika 4; ligjin 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar neni 12 dhe 13, dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

- 1- Miratimin e projektit të objektit “Ndërtim i 4 lulishte në fshatin Velmish”.
Projekti përmban punime ndërtimi.
- 2- Vlera totale e projektit : 1 524 939 lekë me TVSH.
- 3- Nuk ka nevojë për financim pasi projekti do të mbulohet me materialet e blera gjatë vitit.
- 4- Punimet për realizimin e investimeve do të bëhen me punonjesit e Ndërmarrjes së Shërbimeve të Mirëmbajtjes së Rrugëve, e cila ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi.
- 5- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska

